

CRNA GORA
MALI I ZI
OPŠTINA ULCINJ
KOMUNA E ULQINIT
KABINET PREDSDJEDNIKA
KABINETI I KRYETARIT
Br./Nr: 01-040/24-1364/1
Ulcinj/Ulqin, 25.09.2024.godine

Bazuar në nenin 58. të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi nr. 02/18. dhe 34/19, 39/20, 50/22, 84/22 dhe 85/22.) dhe nenit 110. paragrafi 1. pika 3. të Statutit të Komunës së Ulqinit (Gazeta Zyrtare e Malit të Zi - Rregulloret komunale, nr. 48/19 dhe 5/24), dhe në lidhje me nenin 10. të Ligjit për kulturën ("Gazeta Zyrtare e Malit të Zi", nr. 049/08, 016/11, 040/11, 038/12.) dhe Programin Kombëtar për Zhvillimin e Kulturës 2023-2027, Kryetari i Komunës së Ulqinit miraton:

VENDIMI
PËR FILLIMIN NË HARTIMIN E PROGRAMIT PËR ZHVILLIMIN E KULTURËS TË KOMUNËS SË
ULQINIT 2025-2029. VITI

Neni 1.

Komuna e Ulqinit do të fillojë hartimit të Programit Zhvillimor Kulturor të Komunës së Ulqinit 2025-2029. vit (në tekstin e mëtejme: Draft programi zhvillimor kulturor).

Neni 2.

Për hartimin e draft Programit për zhvillimin e kulturës do të formohet një grup pune, ku do të përfshihen punonjës të administratës Lokale, përfaqësues të institucioneve në fushën e kulturës, Organizatës Turistike të Ulqinit, ekspertë të kulturës dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare që veprojnë në fushën e kulturës dhe artit.

Do të shpallet ftesë publike për emërimin e kandidatit për anëtar të grupit punues nga paragrafi 1 i këtij neni për përfaqësues të organizatave joqeveritare.

Grupi i punës do të caktohet me vendim të veçantë të Kryetarit të Komunes.

Neni 3.

Detyra e grupit të punës është që në bazë programit Nacional të zhvillimin e kulturës 2023-2027, dhe modelit të programit të pregaditur nga Bashkija të Komunave të Malit të Zi hartojë një program zhvillimor kulturor që përfshin nevojat afatgjata të popullsisë vendase dhe subjekteve nga fusha e kulturës, prioritetet zhvillimore, dinamikën e realizimit dhe masat organizative, financiare dhe administrative për realizimin e tij.

Neni 4.

Pas hartimit të Programit Zhvillimor do të mbahet diskutim publik, do të përcaktohet propozimi i Programit për Zhvillimin e Kulturës dhe do t'i dorëzohet Kuvendit të Komunës së Ulqinit për miratim.

Neni 5.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit dhe do të publikohet në tabelën e shpalljeve dhe në ueb faqen e Komunës së Ulqinit.

Numri: 01-040/24-1364/1
Ulqin, 25.09 2024.



KRYETARI,

Genci Nimanbegu

Genci Nimanbegu